



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 101/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Grupi i Operatoreve Ekonomik: “Abkons” SH.P.K & Hidroing-DK SH.P.K &FCG Swedish Development AB, me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, rruga “Themistokli Gërmenji”, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i prokurimit, me seli në Prishtinë me objekt kontesti anulim i vendimit PSH.nr.569/19 i datës 07.09.2019, jashtë seancës, me datë 02.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Konstatohet e tërhequr padia e paditësit Grupi i Operatoreve Ekonomik: “Abkons” SH.P.K. &Hidroing-DK SH.P.K., &FCG Swedish Development AB, me seli në Tiranë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i prokurimit, me seli në Prishtinë, për shkak për shkak anulimit të vendimit PSH.nr.569/19 i datës 07.09.2019.
- II. Shpenzimet e procedurës mbeten barrë e paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datën 06.04.2019 ka ushtruar padi A.nr. 2907/19, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, për shkak për shkak anulimit të vendimit PSH.nr.569/19 i datës 07.09.2019.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr.101/22

Paditësi me anë të parashtresës së datës 14.03.2024 në këtë gjykatë, ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë për këtë çështje të konfliktit administrativ, me arsyetim se pas vlerësimit të rrethanave çështja në proces nuk paraqet interes për paditësin as në aspektin komercial dhe as material sepse është pa ndikim në zhvillimin e biznesit.

Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së paditësit për tërheqje të padisë të konstatuar nëpërmjet parashtresës së datës 14.03.2024, konstatoj se paditësit i tërheq padinë me deklarinimin e tij të lirë dhe i vetëdijshëm për pasojat ligjore të tërheqjes së padisë, andaj konform nenit 261 par.2 dhe par. 3 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
KP.nr.101/22, datë 02.04.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.